



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 23 Prot.

Kamëz, më 19 . 02 .2021

V E N D I M

Nr. 20 Datë 19 . 02 .2021

PËR

**HEQJEN NGA LISTA E INVENTARIT PËR PASURITË TRUALL DHE NDËRTIM,
PËR FSHATRAT ZALLMNER DHE BULÇESH**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **19.02.2021** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , në mbështetje të Rregullores së miratuar të Këshillit Bashkiak Kamëz **Nr.05 Datë 14.01.2021**, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr. 775, datë 05.09.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz, Qarku Tiranë”, të VKM-së nr.317, datë 19.06.1995 “ Për Sistemimin me Tokë Bujqësore dhe Truall Ndërtimi të Fshatrave Zallmner, Bulçesh, Bruz”, VKM-së nr.828, datë 23.11.2016 “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për kalimin e së drejtës së pronësisë pa pagesë, mbi truallin dhe objektet e ndërtuara për familjet e shpërngulura nga ndërtimi i ujëmbledhësit të Bovillës” si dhe në propozimin për miratim nga Këshilli i Bashkisë Kamëz “Për heqjen nga lista e inventarit për pasuri të llojit truall dhe ndërtesë, në përdorim të Bashkisë Kamëz, për fshatrat Zallmner dhe Bulçesh”, struktura e posaçme e ngritur me urdhërin nr.248, datë 22.06.2020 “Për ngritjen e strukturës së posaçme, për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procedurave të përfundimit të proceseve kalimtare të pronësisë në Bashkinë Kamëz” **Këshilli Bashkiak Kamëz:**

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën për heqjen nga lista e inventarit, për pasuritë me numër: **8/9 deri 8/202, lloji i pasurisë truall, me numër rendor nga 117 deri në 316, me sipërfaqe totale prej 6.0175 ha truall dhe 21789 m² ndërtim, zk 2066 për fshatin Zallmner.**
2. Të miratojë kërkesën për heqjen nga lista e inventarit, për pasuritë me numër pasurie **249/3/1 deri në 249/12/1 dhe 250/2, 250/31, 250/33, 250/35 me numër**

rendor nga 589 deri në 601, sipërfaje prej 5.613 ha truall dhe ndërtim 590 m², për fshatin Bulçesh.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit të Tokës, Përmirësimit në Mjedis, Bordi i Kullimit, Pyje & Kullota dhe Kryetari i Bashkisë Kamëz.

Bashkëlidhur lista e pasurive që Këshilli Bashkiak Kamëz, për tu hequr nga lista e inventarit, e miratuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 775 datë 05.09.2013

“Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të palujtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz të Qarkut të Tiranës”.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Nën/Kryetar Këshilli

